



REPUBLICA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRILJENO:

12-11-2018

Nr.No.Br.

02/465

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/

Datë: 12.11.2018

Procesverbal

i mbledhjes së VI (gjashtë) të Komitetit për Politikë dhe Financa

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- urgjente dhe të mbledhjes së -IV- të jashtëzakonshme të KPF-së.
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor financiar për vitin 2018.
3. Informimi nga Drejtoria për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore dhe ndarjes së subvencioneve.
4. Raporti i DKAE-së për përgatitjet dimërore nëpër Shkolla.
5. Informimi nga Kryetari i Komunës, dhe Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për mbështetjet e familjeve të varfra.
6. Shqyrtimi i kërkesave.
7. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 02.11.2018, filloj në ora 10, morën pjesë 4 anëtarë të KPF, zyra për informim, qytetar.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve në mbledhje sot mungon Valon Krasniqi por me arsye sepse më ka njoftuar që s'mund të marrë pjesë në mbledhje. Sa ju përket pikave të rendit të ditës për disa pika ka material por për disa unë kam kërkuar edhe me shkrim nga drejtorët por ata nuk na kanë sjellë, pastaj kemi disa kërkesa që disa janë me protokoll të zyrës së kryetarit dhe duhet tja përcjellim. Disa kërkesa janë për lirim nga taksa për ndërtim pasi që nga Ministria kanë fituar grante për Bujqësi, mirëpo disa në vitin 2018 ata kanë paguar këto taksa vetë, tash duhet të mendojmë si tja bëjmë.

Hashim Vrenezi: Kjo mundet të rregullohet dhe të futet në Rregulloren për Taksa dhe ngarkesa mbasi është në proces.

Alban Krasniqi: Ketë çështje të kërkesave për lirim të taksave për leje ndërtimi duhet me këqyr me harmonizuar edhe sipas Ligjit, të raporti i DKA, duke parë rekomandimet e Komitetit të Arsimit, zhvillimet në Gjimnaz rreth atyre aferave, pastaj ende aneksi s'është lëshuar ka klasë të ngarkuar deri në 60 nxënës nëpër klasë e në kushte jo të mira. Vitin e kaluar nxënësit janë merdhi e tash krejt këto të përfshihen në pikën e Arsimit për debat, ose te ndahet në nënpika.

Hashim Vrenezi: Është pikë më rendësi e mirë kishte me qenë të renditen a,b,c.

Raimonda Krasniqi: Në Arsim gjendja është alarmante, por udhëheqësit forcën e kanë kund tjetër e krejt barra bie mbi nxënësit.

Rrahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin 4 anëtarët e KPF-së.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I- urgjente dhe të mbledhjes së -IV- të jashtëzakonshme të KPF-së.

Rrahim Morina: Nëse s'keni diçka rreth procesverbaleve, kush jeni për miratimin e tyre? Unanimisht ishin për 4 anëtarët e KPF-së.

2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor financiar për vitin 2018.

Hashim Vrenezi: E kam lexuar këtë raport janë disa çështje që duhet pyetur drejtorët ose Kryetarin e Komunës.

Rrahim Morina: Ju çka do që keni pyetje bëni me shkrim.

Hashim Vrenezi: Të hyrat në Inspektorat dhe Agjencia e pyjeve pse janë zero, Komuna si trajton ose qytetarët prej drejt dru kur donë edhe askush nuk merret me ta. Të hyrat më shumë janë rritur nga gjobat në trafik por jo që Komuna ka pas ndonjë performancë të mirë. Nga viti 2017 të hyrat nga udhëzimet jashtë vendit si shpenzime janë trefishuar, shpenzimet intelektuale janë mbi 18 mijë euro në vit, shpenzimet e Arsimit në trajnime janë dyfishuar, shpenzimet kontraktuese tjera janë trefishuar, të shpenzimet e varrimit ka pas sqarime, shpenzimet

mjekësore po ashtu. Të shpenzimet për dru pse tani ka dallim nga viti 2017, mirëmbajtja rutinore, dreka zyrtare janë trefishuar, vendimet e Gjykatave por me dite nga cilat raste a penalizuar Komuna, shpenzimet postare nuk janë përcjellur në total, furnizimet për dokumente blanko por nuk dihet çka janë mbi 11 mijë euro.

Alban Krasniqi: Në raport ceken shpenzimet tjera e mbi 100 mijë euro ju kanë dhënë dy shoqatave ose OJQ, pastaj klubeve tjera dikund 50 mijë euro të kemi shpjegim për këto. Ajo çka përcillet më se paku është raport. Raporti financiar është edhe shpalosje, raport narrativ, përmenden donacione të hyra dikund të paraqitura e dikund jo dhe pse ka ndodhë. Ky nivel tani na pamundëson diskutim përmbajtjesor, sepse nganjëherë diskutimet në raport nuk janë kualitative për shkak të mungesës së informacioneve shtesë, pastaj s'kemi listë të projekteve që janë në realizim e sipër. Për këto shpenzime ndoshta është mirë me kërkuar prej prokurorisë pse ka keqpërdorim kështu me ditë sa ka pas mjete, sa kanë tepruar apo ka nevojë mi bartur.

Hashim Vrenezi: Në raport ceken vendime gjyqësore mbi 70 mijë euro dhe janë marrë nga shpenzimet kapitale. Pastaj ka shpenzim 50% e punët janë vonuar.

Rrahim Morina: Me kërkuar nga prokurimi specifikacion për projektet që janë krye, në realizim e sipër dhe ato që pritet mu kry. Të vendimet e Gjykatave të specifikacion, pastajv pse ska të hyra në Arsim.

Kush jeni për rekomandim të këtij raporti për Kuvend. Unanimisht për ishin 4 anetar.

3. Informimi nga Drejtoria për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore dhe ndarjes së subvencioneve.

Hashim Vrenezi: Unë jam me rekomanduar për Kuvend.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim të kësaj pike për Kuvend. Unanimisht për ishin 4 anëtar.

4. Raporti i DKAE-së për përgatitjet dimërore nëpër Shkolla.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim të kësaj pike për Kuvend. Unanimisht për ishin 4 anëtar.

5. Informimi nga Kryetari i Komunës, dhe Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për mbështetjet e familjeve të varfra.

Alban Krasniqi: Për këtë pikë duhet raport nga Kryetari që sa familje janë ndihmuar, Kpf sa ka ndihmuar më mjete financiare, dhe sa shtëpi janë ndërtuar, lista e përfituesve individual të specifikohet.

Rrahim Morina: Kush jeni për rekomandim të kësaj pike për Kuvend. Unanimisht për ishin 4 anëtar.

5. Shqyrtimi i kërkesave.

Rrahim Morina: Kemi disa kërkesa për lirim nga taksa për leje ndërtimi, sepse kanë përfituruar grante në Ministri e tash po kërkojnë të lirohen nga këto taksa.

Hashim Vrenezi: Unë jam mi përkrahë bizneset sidomos që merren me bujqësi, sepse në Komunën tonë bujqësia po shkon në rënie. Ndoshta këto kërkesa është mirë të parashihen në rregulloren për taksa të vitit 2019 dhe taksa të jetë zero, por nëse këta lirohen mos t'i dëmtojme tjerët, sepse ka ndoshta që edhe kanë paguar vetë.

Alban Krasniqi: Jam mi përkrahë bujqit por me kanë e bazuar në standarde, sepse ne e dimë se edhe në Ministri fort nuk ka standarde për grante kur ata donë me ndihmuar dikë. Mire është me ditë a po kanë suksese këta që po ndihmohet apo ka barazi, kur dikush edhe me forca ta veta veprojnë, pra me pas një vendim të bazuar dhe të përgjithshëm e jo për raste ose Komiteti për Bujqësi mi definuar kriteret.

Rrahim Morina: Jam qe të lirohen nga këto taksa të gjithë edhe ata që kanë përfituruar grante edhe ata që vazhdojnë me të hyra të veta.

Alban Krasniqi: Drejtoria për Urbanizëm, Bujqësia duhet me dhënë informacione shtesë sa kanë qenë përfitues, sa kanë paguar sepse nuk janë krejt të natyrës së njëjtë. A ka ndonjë Udhëzim Administrativ që përcakton pagesën për këto ndërtime. Nëse ata nuk sjellin këto informacione ata vet po i vonojnë pastaj.

Rrahim Morina: Kush jeni që këto kërkesa për lirim prej taksës për leje ndërtimi të rekomandohen për Kuvend? Unanimisht ishin për 4 anëtarët e KPF-së.

Kërkesa nr.02/438 datë: 01.11.2018 e Milazim Dukollit për ndërrim destinomi të tokës.

Alban Krasniqi: Është mbajt një debat publik për Rregulloren për Tokën Bujqësore, tani se di Drejtoria pse ka ngecë, unë rreth kësaj kërkesë do të abstenoj se po bëjmë shkelje, sepse janë çështje që po prekin Planin Zhvillimor Komunal.

Rrahim Morina: Po kërkojmë informacione shtesë nga Drejtoria për Gjeodezi sepse këtë kërkesë dikush tjetër e ka kërkuar e kopja e letërnjoftimit është e dikujt tjetër në lëndë. Kush jeni ta përcjellim për drejtorinë për Gjeodezi ata të na sjellin raport sqarues? Unanimisht ishin për 4 anëtarë.

Rrahim Morina: E kemi një kërkesë të fshatit Drenoc për rreth një kanalizimi mirë është ndoshta me sjell për Urbanizëm këtë kërkesë.

Hashim Vrenezi: Është fjala për Drenoc për një kanalizim që kalon nëpër pronë private, dikush po e pengon e aj është kanalizim publik mirë është ky problem të diskutohet dhe kryetari me marrë masa.

Rrahim Morina: Unë mendova me përcjellë për Urbanizëm, por nëse jeni të pajtimit e tregojmë në Kuvend, kush jeni për? Unanimisht 4 anëtarë ishin për.

Rrahim Morina: Është një kërkesë për disa projekte për fshatin Drenoc por tash buxheti është miratuar.

Alban Krasniqi: Unë ju kam kërkuar që ata kërkesat t'i specifikojnë ata si kanë sjellë.

Hashim Vrenezi: Disa vendime të Kuvendit spo zbatohen nga qeveria Komunale.

Raportit nr.02/431 datë: 29.10.2018 të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/432 datë:29.10.2018 të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Raimonda Krasniqi: Te rekomandimet t'i shtohet pika 9 sepse të furnizimet sidomos të hartat ka gabime që i kemi përmirësuar me nxënës pra të mbikëqyren kompanitë furnizuese pra të shtohet kontrolli, të shtohet kontrollimi i verifikimit të dokumenteve të mësimdhënësve që janë pranuar 2018/2019 sidomos të drejtimet dhe numri i kredive.

Rrahim Morina: Kush jeni edhe raporti edhe rekomandimet e Komitetit për Arsim te rekomandohen për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/371 datë:01.10.2018 e parashtruar nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Kosovës Dega në Malishevë për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Terpezë e Ulët.

Rrahim Morina: Ketë kërkesë duhet ta përcjellim për zyrën e kryetarit aj duhet me dhanë ndonjë sqarim, sepse kjo kërkesë ska as pëlqim të fshatin vetëm si kërkesë.

Unanimisht ishin ti përcillen zyre së Kryetarit të Komunës.

Kërkesa nr.02/391 datë: 09.10.2018 të parashtruar nga Istref Rudi nga fshati Rud për marrje në shfrytëzim të pronës së paluajtshme.

Rrahim Morina: Edhe ketë kërkesë e përcjellim për zyrën e kryetarit? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/353 datë:18.09.2018 të parashtruar nga "TIMI" Kosova, Drenofci 5 me pronar Agim Krasniqi nga fshati Drenoc.

Alban Krasniqi: Për këto kërkesa duhet me kanë ndonjë jurist dhe mi trajtu mirë, ose ketë kërkesë me trajtu Komisioni për dhënien në shfrytëzim te pronës.

Rrahim Morina: Se di sa kemi të drejtë me ja nderru veprimtarinë e punës, unë kam kërkuar nga Kryetari që Komuna me pas një zyre ligjore mi trajtu krejt çështjet.

Hashim Vrenezi: Mund ta trajtojmë ketë kërkesë edhe në Kuvend.

Rrahim Morina: Kush jeni pra kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend për trajtim? Unanimisht ishin për rekomandim të kësaj kërkesë.

Kërkesa nr. 01/1264 datë: 31.08.2018 e parashtruar nga Haxhi Hazrolli nga fshati Banjë.

Rrahim Morina: Kjo kërkesë ka protokoll të zyrës së kryetarit, duhet të ja përcjellim nëse aj mendon duhet me sjellë një arsyetim. Kush jeni kjo kërkesë të përcjellët për zyrën e kryetarit? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/437 datë:31.10.2018 të parashtruar nga kryesia e fshatit Kërvasari.

Rrahim Morina: Këta si kryesi e fshatit janë ankuar se një gurëthyes ju krijon rrezik, urbanizmi ju ka lëshuar leje atij gurëthyesi e aj është në pronë private.


Kush jeni që ketë kërkesë me rekomanduar për Kuvend për trajtim? Unanimisht ishin për.

Rrahim Morina: Nëse dikush nuk ka diçka atëherë ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:50 minuta.

Procesmbajtësi:

Naim Avdijaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

